



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|--|------------|--------------------|-------------------|
| Pranuar - Prifetur Me Datë: 02-12-2008 | | | |
| Nr. i organit Org. broj | Numri/Broj | Udhëzues Pellaj | Vlera Vrednisi |
| 02-035/07-45 | | | |



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
KOMUNËS SË VITISË
DHE
AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL (AZHR) LINDJE**

**PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE NE FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK
LOKAL DHE RAJONAL**

DUKE PASUR PARASYSH se, Agjencia per Zhvillim Rajonal Lindje (më tutje referuar si "AZHR Lindje") është një organizate jo qeveritare e themeluar sipas "Marrëveshja për bashkëpunim ndër-komunal në Zonën Ekonomike- Lindje", të datës 16.12.2008 nga 11 Komunitat e rajonit ekonomik Lindje (Gjilan, Ferizaj, Kamenicë, Viti, Partesh, Kllokot, Ranilluk, Kaçanik, Shtërpçe, Novobërdë dhe Hani i Elezit, e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me nr. të certifikatës 5112181-3 me certifikatë të numrit Fiskal 600441464 me adresë Bulevardi i Pavarësisë nr 51. Gjilan, Kosovë, me përfaqësues ligjor z. Agim Zeka, dhe për mision ka të udhëheq, lehtësoj dhe forcoj zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal si dhe ndërtimin e kapaciteteve, përkrahjes në implementimin e projekteve dhe kordinimin e aktiviteve dhe politikave zhvillimore në Komunitat e rajonit ekonomik Lindje.

DUKE PASUR PARASYSH se, Komuna e Vitisë, e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (më tutje referuar si "Komuna Viti"), është një nga themelueset e AZHR Lindje dhe është e angazhuar të ndërmarrë veprime që çojnë drejt zhvillimit ekonomik lokal të qëndrueshëm dhe për planifikim strategjik dhe pjesëmarrës, si dhe të planifikojë zbatimin, përmirësimin e dialogut publiko-privat, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe bashkëpunimin ndër-komunal;

DERISA, AZHR Lindje dhe Komuna e Vitisë, duke u bazuar në Nenin 17, Pika S, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; "Marrëveshja për bashkëpunim ndër-komunal në Zonën Ekonomike- Lindje" Pika 8, 10 (paragrafi a dhe b) dhe 11 (paragrafi e); Statuti i AZHR Lindje Neni 3.1 dhe 3.2 (paragrafi e) kanë rënë dakord të intensifikojnë bashkëpunimin duke ofruar shërbime shtesë përmes angazhimit të 5 konsulentëve të rinj të cilët do të kontribuojnë në:

- Promovimin e zhvillimit ekonomik lokal;
- Asistencë në ofrimin e informatave relevante gjatë përgatitjes së Studimeve të Fizibilitetit për projekte zhvillimore;
- Mbështetje teknike gjatë përgatitjes së dokumenteve strategjike komunale të inicuar nga Komuna e Vitisë gjatë kohëzgjatjes së kësaj MB;
- Mbështetje për tërheqjen e investimeve nga investitorë vendor dhe ndërkombëtar;

- Asistencë në organizimin dhe/ose bashkë-organizimin e aktiviteteve promovuese të bizneseve të Komunës (panaie lokale, rajonale, kombëtare, forume, B2B etj)
- Përgatitjen e 25 projekt koncepteve komunal dhe ndër-komunale si dhe asistencë në përgatitjen e projekteve të investimeve publike për aplikim në thirrje për propozime nga niveli qendror dhe donator.

DERISA, AZHR Lindje dhe Komuna e Vitisë (më tutje referuar kolektivisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala") njohin përfitimet e një bashkëpunimi të mirëfilltë, thelbësor dhe dëshirojnë të ndjekin një bashkëpunim të tillë (bashkë-implementimi i aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal në Komunën e Vitisë), hyjnë në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit (më tutje referuar si "MB") në një frymë besimi dhe bashkëpunimi;

Palët bien dakord si më poshtë:

NENI I

Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. AZHR Lindje dhe Komuna e Vitisë lidhin këtë MB me qëllim të bashkëpunimit për ofrimin e shërbimeve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik lokal.
2. Qëllimi i bashkëpunimit do të jenë si në vijim:
 - (a) Involvimi i Komunës së Vitisë në realizimin e kësaj MB;
 - (b) Involvimi i AZHR Lindje në aktivitete me fokus zhvillimin ekonomik lokal të bazuar në praktika vendore dhe ndërkombëtare dhe në nevoja/kërkesa lokale me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal;
 - (c) Përmirësimi i kapaciteteve lokale dhe koordinimi i tyre për t'i adresuar sa më mirë nevojat e Komunës së Vitisë në fushën e zhvillimit socio-ekonomik lokal;
 - (d) Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve lokale me qëllim absorbimn e investimeve publike si dhe për të lehtësuar investimet e sektorit privat;

NENI II

Përgjegjësitë e Palëve

1. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, secila prej palëve zotohet t'i zbatoj përgjegjësitë e mëposhtme me qëllim të realizimit sa më të mirë dhe efikas të qëllimit të këtij bashkëpunimi.
2. Komuna e Vitisë do të:
 - 2.1 Krijoj kushte pune për konsulentët e angazhuar duke përfshirë edhe pajisje të teknologjisë informative

- 2.2 Komuna e Vitisë (Drejtoria për Zhvillim Ekonomik) do të bashkëpunojë ngushtë me konsulentët e rinj duke l'u ofruar atyre të dhëna dhe informata relevante lidhur me fushëveprimin dhe arritjen e qëllimeve të kësaj MB;
3. AZHR Lindje do të:
- 3.1 Mbështet Komunën e Vitisë me ekspertizë të brendshme si dhe përmes angazhimit të konsuletëve për t'i ndërtuar kapacitetet e nevojshme për promovimin e zhvillimit ekonomik lokal dhe përkrahje të sektorit privat;
- 3.2 Bashkëpunon me Komunën e Vitisë për realizimin e suksesshëm t kësaj MB;

NENI III
Buxheti dhe Procedurat e Kompenzimit

Buxheti i paraparë për realizimin e kësaj MB është si në vijim:

| Buxheti | Shuma € | % |
|--|--------------------|-------------|
| 1. Angazhimi i konsulentëve * | 17,500.00 € | 80% |
| 2. Shpenzimet operative dhe menaxhuese | 4,375.00 € | 20% |
| Totali: | 21,875.00 € | 100% |

* Në kuadër të kësaj MB do të angazhohen gjithësej 5 konsulentë për periudhë 10 mujore me kompenzim mujor prej 350 € bruto.

Mënyra e pagesës:

Komuna e Vitisë do të transferoj në llogarinë e AZHR Lindje pagesën në shumën prej 21,875.00 €.

| | |
|----------------------------------|---------------------------------------|
| Emri i përfituesit: | AZHR LINDJE |
| Numri i llogarisë bankare | 1960 6922 6703 1120 BKT Gjilan |

NENI IV
Kordinimi dhe Konsultimet

Palët pajtohen që gjatë implementimit të kësaj MB, do të shkëmbejnë informacione dhe do të takohen rregullisht për të vlerësuar efektivitetin e mbështetjes nga AZHR Lindje si dhe dinamikat e implementimit të kësaj marrëveshjeje.

NENI V
Provizionet e përgjithshme

1. Amandamenti apo shkëputja e Marrëveshjes.
 - 1.1 Palët kanë të drejtë të shkëpusin këtë Marrëveshje duke dërguar paralajmërim me shkrim së paku 30 ditë më herët.
2. Data e hyrjes në fuqi dhe kohëzgjatja.
 - 2.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët ndërsa realizimi i saj përfshinë periudhën 01.03.2023-31.12.2023.
3. Përfaqësimi.
 - 3.1 Palët do të përfaqësohen nga persona të mandatuar nga nënshkruesit e marrëveshjes.

NENI VI
Pëlqimi i palëve

1. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të kësaj MB.
2. Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshje do të zgjidhen në mënyrë miqësore, me marrëveshje koncesuale.

NENI VII
Konflikti i Interesit

1. Palët garantojnë se në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje nuk ekziston ndonjë konflikt interesi ose ka të ngjarë të lindë gjatë zbatimit të kësaj MB.
2. Nëse lindë ndonjë konflikt interesi ose ka të ngjarë të shfaqet gjatë kohëzgjatjes së kësaj MB, palët duhet të:
 - (a) Të njoftojnë njëri-tjetrin menjëherë;
 - (b) Të bëjnë njoftimin e të gjitha informacioneve përkatëse në lidhje me konfliktin

| | |
|--|---|
| <p>Për Komunën e Vitisë z. Sokol Balli</p> <p>Kryetar i Komunës së Vitisë</p> <p>Data:</p> | <p>Për AZHR Lindje z. Agim Zeka</p> <p>Drejtor ekzekutiv i AZHR Lindje</p> <p>Data:</p> |
|--|---|